

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupi gjykues Beqir Halili, me procesmbajtësen Qëndresa Tahiri, në çështjen penale kundër të akuzuarve: R.B. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarit F.S. për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PPI.nr.1147/2017 të datës 11.09.2018, të cilën e përfaqëson Prokurori Njazi Rexha, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 19.02.2019, në prezencën e të akuzuarve R.B. dhe F.S., e në mungesë të prokurorit Njazi Rexha , po të njëjtën ditë edhe shpalli, ndërsa me datën 25.02.2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. R.B., me nofkën "...", i biri i B. dhe Xh., e gjinisë R., i lindur me *data e lindjes*, në ..., ku edhe jeton në rrugën “...” nr. ..., me numër personal *numri i leternjoftimit*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin Filologjik e po ashtu edhe masterin në shkencat Sociologjike, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa gjykuar, ndaj të njëjtit nuk zbatohet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

II. F.S., i biri i N. dhe M., e gjinisë D., i lindur me *data e lindjes*, në ..., me vendbanim në ... në rrugën “...” nr. ..., me numër personal *numri i leternjoftimit*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme-drejtimi tregti, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa gjykuar, ndaj të njëjtit nuk zbatohet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

JANË F A J T O R

I. I akuzuari R.B.,

SEPSE: Me datën 28.05.2017 rreth orës 00:40 minuta, në rrugën “...”, pa autorizim e me qellim shitje ka poseduar substancë narkotike-marihuanë, në atë mënyre që Njësiti i Reagimit të shpejtë (NJRSH) ka ndaluar veturën e markës Mercedes me targa ... të cilën e ka drejtuar F.S. e si pasagjer kishte R.B. dhe G.I., e me rastin e kontrolles në automjet në ulësen e parë të pasagjerit-R.B. është gjetur një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë dhe nën ulësen

e njëjtë janë gjetur edhe dhjetë qese me substanca të dyshuara narkotike që pas matjes ka rezultuar në peshë 16.08 gram.

- Më këtë kanë kryer veprën penale **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së.**

II. I akuzuari F.S.,

SEPSE: Me datën 28.05.2017 rreth orës 00:40 minuta, në rrugën "...", pa autorizim ka poseduar substancë narkotike-marihuanë, në atë mënyre që është ndaluar nga Njësitii i Reagimit të shpejtë (NJRSH) në rrugën "..." deri sa e drejtonte automjetin Mercedes me targa ..., me ç'rast gjatë kontrollit tek i pandehuri në xhepin e brendshëm të xhaketës së tij është gjetur një qese me substancë marihuanë në peshë prej 0.51 gram, dhe konfiskuar.

- Më këtë kanë kryer veprën penale **Posedim i paaautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.**

Në bazë të dispozitave të nenit 41, 45, 69, 73, 75, 76, dhe 273 par. 5 të KPRK-së dhe nenit 365 e 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPP-së, i

G J Y K O N

I. Të akuzuarit R.B., i shqipton DENIM ME BURG në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) Euro.

II. Të akuzuarit F.S., i shqipton DENIM ME BURG në kohëzgjatje prej tre (3) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) Euro.

Nëse të akuzuarit dënimin me gjobë nuk e paguajnë në afat prej tre (3) muajve, gjykata mund tua zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim. Kur dënimi me burg zëvendësohet me dënim me gjobë një (1) ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës dhe në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj secili veç e veç shumën prej nga njëqind (100) Euro, si dhe shumën secili veç e veç prej pesëdhjetë (50) Euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave.

Të akuzuarve ju KONFISKOHEN:

Të akuzuarit R.B., ju konfiskohet substancat narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 16.08 gram, ndërsa të pandehurit F.S. i konfiskohet substancat narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 0.51 gram.

Të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes se aktgjykimit të akuzuarit R.B. dhe F.S., deklaruan se e japim pëlqimin që dënimi me burg të zëvendësohet me dënim me të holla.

Gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 47 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I. Të akuzuarit R.B. dënimi me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve i'u ZEVENDESOHET me dënim me gjobë, ashtu që i pandehuri R.B. , obligohet që të paguaj dënimin me gjobë në shumë prej njëmijepesëqind (1500) Euro.

II. Të akuzuarit F.S. dënimi me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muajve i'u ZEVENDESOHET me dënim me gjobë, ashtu që i pandehuri F.S., obligohet që të paguaj dënimin me gjobë në shumë prej tetëqind (800) Euro.

Të akuzuarit, Obligohen që dënimet e zvetënuara, ti paguajnë me këste në afat prej tre (3) muajve, prej ditës se marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mundën ta paguajnë gjobën, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burg llogaritet me njëzet (20) Euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PPL.nr.1147/2017 të datës 11.09.2018, në çështjen penale kundër të akuzuarve: R.B. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarit F.S. për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 19.02.2019, të akuzuarit R.B. dhe F.S., e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat ngarkohen.

Pas pranimit të fajësisë prokurori Njazi Rexha deklaroi se: Duke pasur parasysh të pandehurit e pranojnë fajësinë në mënyre vullnetare pa presion e në mbështetje më provat që gjenden në shkresat e lendes i propozoj gjykatës që tua pranoi fajësinë të pandehurve.

Pas pranimit të fajësisë të akuzuarit u njoftuan me pasojat e pranimit të fajësisë nga neni 248 të KPP-së dhe deklaruan se janë e njoftuar me pasojat e pranimit te fajësisë, pranimin e

fajësisë e bëjnë vullnetarisht pa kurrfarë presioni, pa kurrfarë ndikimi, janë në gjendje të mire psikike, nuk janë nën ndikimin e asnjë materie psikotropike e cila kishte me ndikuar në psikikën tyre, prandaj janë plotësisht të vetëdijshëm për deklaratat të cilat i dhamë.

Pasi që të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, Kryetari i trupit gjykues vlerësoi se pranimit i fajësisë është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lendes dhe atë: Raporti i ekspertizës AKF/2017-1782/2017-611 i datës 25.08.2017, Vërtetimi mbi konfiskimin e pasurisë i datës 28.05.2017 nga i pandehuri R.B., Vërtetimi mbi marrjen e sendeve nga i pandehuri F.S. si dhe fotodokumentacioni në shkresat e lendes.

Pas pranimit të fajësisë të akuzuarit R.B. dhe F.S. deklaruan se: E pranojnë fajësinë me vullnet, se ju vjen keq që kanë kryer veprat penale dhe i premtojnë gjykate që në të ardhmen kurrë nuk do të kryejnë asnjë vepër penale dhe këto vepra do të jenë të fundit. Me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit kërkojnë nga gjykata që t'ua shqiptoj një dënim sa më të butë.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata si rrethana lehtësuese në vështrim të nenit 74 par. 3 nënpar. 3.3, 3.6, 3.8, 3.10 e 3.11 të KPRK-së i ka marr se: të akuzuarit për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, kanë bashkëpunuar në mënyre korrekte me gjykatën dhe organet e ndjekjes, të akuzuarit e ka pranuar fajësinë, kanë shfaqur keqardhje për veprat e kryera penale, janë penduar se e ka kryer këto vepra dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale.

Duke marr parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallen e rrezikshmërisë shoqërore gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tyre si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për konfiskimin e substanave narkotike të llojit marihuanë nga të akuzuarve, gjykata e ka marr në bazë të nenit 69 par. 1 dhe 273 par. 5 të KPRK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marr në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Në bazë të të dhënave të shënuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.83/2019, me datën 25.02.2019

Procesmbajtësja
Qëndresa Tahiri

Kryetari i trupit gjykues
Beqir Halili

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditësh Gjykatës se Apelit në Prishtinë-Departamentit për Krime të Rënda, përmes kësaj Gjykate.